

20191021276

LIGJ PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

I. DISPOZITA THEMELORE

Themelimi

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen procedura për zgjedhjen e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mënyra e realizimit të funksioneve të tyre, zgjedhja, ndërprerja dhe shkarkimi i gjykatësit dhe gjykatësit porot, procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, përcaktimi i ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjykatësit, ndjekja dhe vlerësimi i punës së gjykatësve, mënyra e punës dhe vendimmarrja dhe çështjet tjera lidhur me punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i themelimit

Neni 2

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Këshilli) është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësisë. Këshilli e siguron dhe e garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor, përmes ushtrimit të funksioneve të veta në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet.

Veprimi politik

Neni 3

- (1) Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në Këshill.
- (2) Anëtarët e Këshillit në ushtrimin e funksioneve të Këshillit nuk guxojnë të realizojnë aktivitet partiak.
- (3) Këshilli me punën e vet pamundëson ndikimin politik në gjyqësi.

Statusi i Këshillit

Neni 4

- (1) Këshilli ka cilësinë e personit juridik.
- (2) Selia e Këshillit është në Shkup.

Vula e Këshillit

Neni 5

- (1) Këshilli ka vulë.
- (2) Vula e përmban emrin Republika e Maqedonisë së Veriut, stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, emrin dhe selinë e Këshillit.
- (3) Në godinën në të cilën gjendet selia e Këshillit theksohet emri dhe selia, stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

II. PËRBËRJA DHE KRYETARI I KËSHILLIT

Përbërja e Këshillit

Neni 6

(1) Këshilli përbëhet prej 15 anëtarëve, prej të cilëve:

- me funksion anëtarë të Këshillit janë kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ministri i Drejtësisë,

- tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjykatësit nga radhët e veta. Tre nga anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me ç'rast do të respektohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve që u takojnë të gjitha komuniteteve,

- tre anëtarë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

- dy anëtarë të Këshillit propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa zgjedhjen e bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilëve njëri është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Anëtarët e Këshillit sipas funksionit marrin pjesë në punën e Këshillit pa të drejtë vote.

(3) Anëtarët e Këshillit sipas funksionit nuk marrin pjesë në punën e mbledhjeve të Këshillit në të cilat debatohet dhe vendoset për procedurën e ngritur për përcaktimin e përgjegjësisë, zgjedhjes ose shkarkimit të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

Neni 7

(1) Anëtarët e zgjedhur të Këshillit nga radhët e gjykatësve kanë mandat prej gjashtë vitesh me të drejtë të rizgjedhjes pas skadimit të së paku gjashtë vitesh nga pushimi i mandatit paraprak në Këshillin Gjyqësor.

(2) Anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë mandat prej gjashtë vitesh me të drejtë të rizgjedhjes.

(3) Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ministrit të Drejtësisë me pushimin e funksionit u pushon edhe mandati në Këshill.

(4) Mandati i anëtarit i cili është zgjedhur në zgjedhjet plotësuese, për shkak të pushimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit në vendin e të cilit është zgjedhur, zgjat gjashtë vjet.

Zgjedhja dhe kohëzgjatja e mandatit të kryetarit të Këshillit

Neni 8

(1) Me punën e Këshillit udhëheq kryetari.

(2) Kryetari i Këshillit ka zëvendës, i cili e zëvendëson në mungesë të tij.

(3) Kryetari i Këshillit dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, të cilët janë zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Kryetari i Këshillit dhe zëvendësi i tij zgjidhen me së paku tetë vota nga anëtarët me të drejtë vote.

(5) Mandati i kryetarit të Këshillit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit zgjat dy vjet pa të drejtë të rizgjedhjes.

III. PROCEDURA PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KËSHILLIT

Shpallja për anëtar të Këshillit

Neni 9

(1) Kryetari i Këshillit ka për detyrë më së voni tri muaj para skadimit të mandatit të Këshillit ose të anëtarit të Këshillit:

- të shpall konkurs për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e gjykatësve,
- ta njoftojë Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që të shpall konkurs për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit që e zgjedh Kuvendi dhe
- ta njoftojë Presidetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i propozojë Kuvendit kandidat për anëtar të Këshillit.

(2) Në rast të pushimit të parakohshëm të mandatit nga neni 7 paragrafi (4) të këtij ligji, kryetari i Këshillit do të veprojë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni në afat prej 15 ditësh pas pushimit të mandatit të anëtarit të Këshillit.

Kohëzgjatja e shpalljes

Neni 10

(1) Shpallja nga neni 9 i këtij ligji botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut " dhe së paku në dy gazeta publike prej të cilave njëra është në gjuhën zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Shpallja zgjat 15 ditë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Nga dita e shpalljes së konkursit deri në ditën e votimit duhet të kalojnë së paku 30 ditë.

Kushtet për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit

Neni 11

(1) Në shpalljen për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e gjykatësve mund të paraqitet çdo gjykatës i cili në momentin e shpalljes së konkursit e ushtron funksionin e gjykatësit dhe i cili i përmbush kushtet si vijon:

- të ketë së paku gjashtë vjet stazh të gjykatësit,
- të ketë vlerësim pozitiv në punën në ushtrimin e funksionit të gjykatësit, dhe
- të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm masa disiplinore zvogëlim i rrogës në lartësi prej 15% deri më 30% të rrogës mujore që zgjat në momentin e publikimit të shpalljes.

(2) Në shpalljen për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit me propozim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të paraqitet çdo person i cili në momentin e publikimit të shpalljes i përmbush kushtet si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jetë jurist i diplomuar me së paku 15 vjet përvojë pune në profesionin juridik me provimin e dhënë të jurisprudencës dhe i cili në ushtrimin e profesionit juridik është theksuar me punë shkencore ose profesionale ose me veprimin e tij publik,
- mos të jetë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit në ushtrimin e funksionit ose vepër tjetër penale me dënim pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj që e bën të padenjë ta ushtrojë funksionin anëtar i Këshillit dhe

- të gëzojë reputacion dhe të posedojë integritet për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit.

(3) Anëtar i Këshillit me propozim të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të zgjedh person i cili në momentin e zgjedhjes i përmbush kushtet si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- të jetë jurist i diplomuar me së paku 15 vjet përvojë pune në profesionin juridik me provimin e dhënë të jurisprudence dhe i cili në ushtrimin e profesionit juridik është theksuar me punë shkencore ose profesionale ose me veprimin e tij publik,

- të mos jetë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit në ushtrimin e funksionit ose vepër tjetër penale me dënim pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj që e bën të padenjë ta ushtrojë funksionin anëtar të Këshillit dhe

- të gëzojë reputacion dhe të posedojë integritet për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit.

(4) Në rastet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, anëtar i Këshillit nuk mund të zgjidhet personi i cili në momentin e shpalljes së konkursit ushtron funksion të gjykatësit ose prokurorit publik ose personi i cili ishte shkarkuar nga funksioni i gjykatësit ose prokurorit publik, përveç nëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar shkelje të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut në procedurën për shkarkim, as personi i cili në katër vitet e fundit ka qenë deputet, anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ka ushtruar funksion në organin e partisë politike.

(5) Anëtarët e Këshillit që i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe anëtarët që i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë nga radhët e profesorëve universitarë të së drejtës, avokatëve, ish-gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjykatësve ndërkombëtarë dhe juristëve tjerë të shquar.

Kandidatura

Neni 12

(1) Kandidatët për anëtar të Këshillit nga radhët e gjykatësve kandidaturën e tyre e parashtrojnë me shkrim te Këshilli.

(2) Me fletëparaqitjen kandidati dorëzon:

- vërtetimin për stazhin e gjykatësit,

- të dhënat biografike për zhvillimin profesional dhe kompetent,

- vlerësimet për rezultatet në punë të lëshuara nga Këshilli,

- të dhënat për pjesëmarrjen në edukimin profesional, të lëshuara nga Akademia për Trajnimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe

- deklaratën se për cilën listë paraqitet.

Komisioni për përgatitjen e listave të kandidatëve

Neni 13

(1) Këshilli nga përbërja e vet formon Komision prej tre anëtarëve për përgatitjen e listave të kandidatëve (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

(2) Komisioni nga kandidaturat e dorëzuara me kohë të kandidatëve që i kanë përmbushur kushtet nga neni 11 të këtij ligji harton lista të kandidatëve dhe i publikon në faqen e internetit të Këshillit.

(3) Listat e kandidatëve përgatiten sipas njërive zgjedhore, edhe atë:

- si listë e përgjithshme për kandidatin nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- si listë e përgjithshme për kandidatin nga rajoni i apelit Shkup dhe nga gjykatat administrative,

- si listë e përgjithshme për kandidat nga rajoni i apelit Manastir,

- si listë e përgjithshme për kandidat nga Gjykata e Apelit Gostivar,

- si listë e përgjithshme për kandidat nga rajoni i apelit Shtip dhe

- si listë e veçantë unike e kandidatëve të gjykatësve pjesëtarë të të gjitha komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Kandidatët të cilët nuk janë të evidentuar në listat e kandidatëve kanë të drejtë kundërshtimi në Këshill në afat prej 48 orësh nga publikimi i listave.

(5) Këshilli në mbledhje vendos për kundërshtimet dhe i përcakton listat e kandidatëve nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Listat e përcaktuara të kandidatëve Këshilli i dorëzon në Komisionin për zbatimin e zgjedhjeve për anëtarët e Këshillit nga radhët e gjykatësve, në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i shpalljes.

Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve

Neni 14

(1) Këshilli formon Komision për zbatimin e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve (në tekstin e mëtejme: Komisioni për zgjedhje).

(2) Komisioni për zgjedhje përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

(3) Kryetari i Komisionit për zgjedhje, një anëtar dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa një anëtar dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve të shoqatave dhe fondacioneve që punojnë më tepër se pesë vjet në sferën e të drejtave të njeriut dhe sundimin e së drejtës.

(4) Tridhjetë ditë para votimit për anëtarët e Këshillit nga radhët e gjykatësve, Këshilli në faqen e vet të internetit publikon thirrje për shoqatat dhe fondacionet nga paragrafi (3) i këtij neni të emërojnë nga një kandidat për anëtar të Komisionit për zgjedhje.

(5) Afati për paraqitjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit për zgjedhje nga shoqatat dhe fondacionet nga paragrafi 3 i këtij neni, zgjat dhjetë ditë nga dita e publikimit të thirrjes.

(6) Kandidat për anëtar të Komisionit për zgjedhjen mund të jetë personi i cili ka mbaruar studime juridike me 300 SETK të fituara ose shkallën VII/1 dhe i cili nuk është dënuar me aktgjykim të prerë gjyqësor për vepër penale me dënim të pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj.

(7) Këshilli e përcakton përmbushjen e kushteve nga paragrafët (3) dhe (6) të këtij neni dhe përcakton listë të kandidatëve për Komisionin për zgjedhje, prej të cilëve nëpërmjet shortit zgjidhen dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

(8) Nëse në thirrjen nga paragrafi (4) të këtij neni nuk ka të paraqitur kandidatë të cilët i përmbushin kushtet për anëtar të Komisionit për zgjedhje, Këshilli i drejtohet Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të propozojë kandidatë për anëtar dhe/ose zëvendës të Komisionit për zgjedhje që i përmbushin kushtet nga paragrafi (6) të këtij neni.

(9) Komisioni për zgjedhje e përgatit materialin zgjedhor, formon këshilla zgjedhorë dhe i zbaton zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve.

Neni 15

Anëtari i Komisionit për përgatitjen e listave të kandidatëve nuk mund të jetë edhe anëtar i Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve dhe anasjelltas.

Zgjedhja për rajonet e apelit

Neni 16

Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve merret parasysh përfaqësimi si vijon i anëtarëve nga rajonet e të gjitha gjykatave të apelit, edhe atë:

- një anëtar zgjidhet nga rajoni i apelit Shkup,
- një anëtar zgjidhet nga rajoni i apelit Manastir,
- një anëtar zgjidhet nga rajoni i apelit Gostivar,
- një anëtar zgjidhet nga rajoni i apelit Shtip,
- një anëtar zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- dy anëtarë zgjidhen nga radhët e gjykatësve pjesëtarë të komunitetit që është më tepër se 20% të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e të gjithë gjykatësve të regjistruar në Regjistrin zgjedhor gjyqësor dhe
- një anëtar zgjidhet nga radhët e gjykatësve pjesëtarë të komunitetit që janë më pak se 20% të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e të gjithë gjykatësve të regjistruar në Regjistrin zgjedhor gjyqësor.

Regjistri zgjedhor gjyqësor

Neni 17

(1) Regjistrin zgjedhor gjyqësor e mban Këshilli Gjyqësor dhe në të përmbahen të dhënat për:

- emrin dhe mbiemrin e gjykatësit,
- numrin unik të amzës,
- gjykatën në të cilën e ushtron funksionin e gjykatësit,
- datën kur për herë të parë është zgjedhur gjykatës,
- përkatësinë nacionale,
- numrin e legjitimacionit zyrtar gjyqësor dhe
- vendin për shënime.

(2) Këshilli Gjyqësor, regjistrin zgjedhor gjyqësor e vë në këqyrje në gjykatë dhe çdo gjykatës ka të drejtë në afat prej tri ditësh në formë me shkrim të kërkojë korrigjimin e të dhënave.

(3) Këshilli Gjyqësor në afat prej tri ditësh nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni vendos me aktvendim.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) të këtij neni mund të ngrejë kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit.

(5) Gjykata kompetente nga paragrafi (4) i këtij neni miraton vendim në afat prej 48 orësh.

(6) Këshilli Gjyqësor më së voni në afat prej 20 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve e përmbyll Regjistrin zgjedhor gjyqësor.

Mënyra e zbatimit të zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjykatësve

Neni 18

(1) Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit nga radhët e gjykatësve zbatohen në ditën e njëjtë.

(2) Zgjedhjet zbatohen në vendvotimet me numër dhe me seli në të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për gjykata.

(3) Zgjedhjet për vendvotimet i zbaton Këshilli Zgjedhor i formuar me aktvendim nga Komisioni për zgjedhje.

(4) Kandidati për anëtar të Këshillit nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Zgjedhor.

(5) Këshilli Zgjedhor përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarët nga radhët e gjykatësve dhe/pse bashkëpunëtorëve profesionalë nga gjykata dhe zëvendësit e tyre.

(6) Komisioni për zgjedhje ka për detyrë që Këshillin Zgjedhor ta formojë shtatë ditë para ditës së votimit.

Materiali zgjedhor

Neni 19

Materiali zgjedhor përbëhet nga:

- kutitë për votim dhe paravanët,
- formularët për procesverbalë,
- blloku me fletëvotime sipas ekstraktit të Regjistrit zgjedhor gjyqësor,
- listat e kandidatëve,
- ekstrakti i Regjistrit zgjedhor gjyqësor dhe
- materiali tjetër i nevojshëm për votim.

Fletëvotimi

Neni 20

(1) Fletëvotimi i përgjithshëm përmban:

- emrin e fletëvotimit,
- njësinë zgjedhore dhe emrin e vendvotimit,
- numrin serik që gjendet në pjesën që mbetet në bllokun amë dhe
- emrin dhe mbiemrin e kandidatëve sipas rendit alfabetik.

(2) Fletëvotimi i veçantë përmban:

- emrin e fletëvotimit,
- njësinë zgjedhore dhe emrin e vendvotimit,
- numrin serik që gjendet në pjesën që mbetet në bllokun amë,
- emrin dhe mbiemrin e kandidatëve, sipas rendit alfabetik,
- të dhënat për përkatësinë nacionale të kandidatëve dhe
- gjykatën nga e cila kandidati kandidohet.

(3) Komisioni për zgjedhje e përgatit formularin e fletëvotimit në pajtim me këtë nen.

Dorëzimi i materialit zgjedhor

Neni 21

Komisioni për zgjedhje ia dërgon materialin zgjedhor kryetarit të Këshillit Zgjedhor më së voni në afat prej 24 orësh para mbajtjes së zgjedhjeve për çka hartohet procesverbali.

Zbatimi i votimit

Neni 22

(1) Votimi zbatohet në ditën e punës.

(2) Votimi fillon në orën 8:00 dhe zgjat pandërprerë deri në orën 15:00.

(3) Gjykatësit votojnë për kandidatët e listës së përgjithshme nga rajoni i tyre i apelit dhe për listën unike të veçantë.

(4) Gjykatësit e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut votojnë për listën e përgjithshme të kandidatit nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për listën unike të veçantë.

(5) Gjykatësit identifikohen me legjitimacionin e gjykatësit dhe votojnë në mënyrë të fshehtë.

(6) Në orën 15:00 vendvotimi mbyllet, ndërsa gjykatësve që janë hasur në lokalet u mundësohet të votojnë.

(7) Këshilli Zgjedhor mund ta mbyll vendvotimin edhe para skadimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse kanë votuar të gjithë gjykatësit e regjistruar në ekstrakt nga Regjistri zgjedhor gjyqësor, por nuk guxon ta hap kutinë e votimit deri në orën 15:00 kur mbyllen të gjitha vendvotimet.

Procesverbali për votim

Neni 23

(1) Pas mbylljes së vendvotimit Këshilli Zgjedhor më së voni deri në orën 18:00 harton procesverbal për rrjedhën dhe rezultatin e votimit dhe e njofton Komisionin për zgjedhje.

(2) Në procesverbal futen të dhënat:

- për numrin e përgjithshëm të daljes së votuesve që kanë votuar,
- për numrin e përgjithshëm të votave që i ka marrë secili kandidat,
- për numrin e fletëvotimeve të pavlefshme dhe
- vërejtjet për rrjedhën e votimit.

(3) Këshilli Zgjedhor në afat prej 24 orësh e dorëzon procesverbalin me rezultatet e votimit dhe materialin tjetër zgjedhor te Komisioni për zgjedhje.

Fletëvotimi i pavlefshëm

Neni 24

Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk është i plotësuar ose ka të rrethuar numër më të madh të kandidatëve që zgjidhet sipas njësisë zgjedhore ose mënyrës tjetër së padyshimtë nuk mundet me siguri të konstatohet vullneti i zgjedhësit. Rezultati zgjedhor

Neni 25

(1) Komisioni për zgjedhje i përmbledh rezultatet nga vendet zgjedhore dhe e përcakton rezultatin zgjedhor në njësitë zgjedhore më së voni në afat prej 48 orësh nga momenti i mbylljes së zgjedhjeve dhe është i detyruar që përmes ueb faqes së Këshillit të sigurojë që publiku ta ndjekë drejtpërdrejt përmbledhjen e rezultatit zgjedhor, ndërsa në rast të mos mund të sigurojë transmetim të drejtpërdrejtë për shkaqe teknike, është i detyruar që të sigurojë incizim të të njëjtit dhe më së voni ditën në vijim ta vendosë incizimin në ueb faqen e tij.

(2) Anëtar i zgjedhur i Këshillit konsiderohet kandidati që ka fituar numër më të madh të votave për njësi zgjedhore.

(3) Nëse më shumë kandidatë kanë fituar numër më të madh dhe të barabartë të votave nga një listë zgjedhore, zgjedhjet për këto kandidatë do të përsëriten në afat prej shtatë ditësh nga dita e votimit.

(4) Komisioni për zgjedhje të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit nga radhët e gjykatësve u lëshon certifikatë.

(5) Formën dhe përmbajtjen e certifikatës do t'i përcaktojë me akt ministri i Drejtësisë.

Procedura për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes së kandidatit

Neni 26

(1) Çdo kandidat mund që në afat prej pesë orësh pas përfundimit të votimit në Komisionin për zgjedhje të parashtrojë kundërshtim për rrjedhën e votimit për anëtar të Këshillit.

(2) Çdo kandidat mund që në afat prej pesë orësh nga shpallja e rezultateve nga votimi për anëtar të Këshillit në Komisionin për zgjedhje të parashtrojë kundërshtim të procedurës për përmbledhje dhe përcaktim të rezultateve nga votimi.

(3) Komisioni për zgjedhje është i detyruar që në afat prej 12 orësh pas pranimi të kundërshtimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni të miratojë vendim.

(4) Kundër vendimit të Komisionit për zgjedhje nga paragrafi (3) i këtij neni në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit mund të parashtrojë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

(5) Për padinë nga paragrafi (4) i këtij neni gjykata kompetente vendos në afat prej 48 orësh nga dita e pranimi të saj.

Procedura për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes së zgjedhësit

Neni 27

(1) Çdo zgjedhës të cilit i është shkelur e drejta e zgjedhësit në procedurë gjatë realizimit të votimit mund që në afat prej pesë orësh pas përfundimit të votimit në Komisionin për zgjedhje të parashtrojë kundërshtim.

(2) Komisioni për zgjedhje është i detyruar që në afat prej 12 orësh pas pranimi të kundërshtimit të miratojë vendim.

(3) Kundër vendimit të Komisionit për zgjedhje në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit mund të parashtrohet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

(4) Për padinë nga paragrafi (3) i këtij neni gjykata vendos në afat prej 48 orësh nga dita e pranimi të saj.

Seanca e Kuvendit në të cilën zgjidhen anëtarë të Këshillit

Neni 28

(1) Në seancën e njëjtë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit që i zgjedh Kuvendi me propozim të trupit punues kompetent të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e kandidatëve të cilët janë paraqitur në shpalljen dhe me propozim të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën zgjidhen anëtarët nga paragrafi (1) i këtij neni është urgjente dhe do të mbahet në afat prej më së shumti 30 ditësh nga dita e zgjedhjes së anëtarëve për Këshillin që zgjidhen nga të gjithë gjykatësit.

Deklarata solemne

Neni 29

(1) Anëtarët e zgjedhur të Këshillit dhe anëtarët sipas funksionit japin deklaratë solemne para Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Deklarata solemne është si vijon:

"Deklaroj dhe betohem se funksionin anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta kryejë në mënyrë të ndërgjegjshme, të përgjegjshme dhe të ndershme dhe do t'i respektoj Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Deklaratën solemne anëtarët e sapozgjedhur e nënshkruajnë.

(4) Anëtarit të sapozgjedhur i jepet ekzemplar nga deklarata e nënshkruar solemne.

Konstitutimi i Këshillit

Neni 30

(1) Mbledhja konstituive mbahet në afat prej 30 ditësh nga zgjedhja e shumicës së anëtarëve të Këshillit.

(2) Mbledhjen konstituive e cakton kryetari i Këshillit gjyqësor paraparak, e nëse në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni kryetari i ish-përbërjes së Këshillit nuk e cakton mbledhjen konstituive, anëtarët e Këshillit mblidhen në ditën e tridhjetë nga dita e zgjedhjes në ora 10:00 dhe e konstituojnë Këshillin.

(3) Me mbledhjen konstituive kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Pushimi i mandatit të anëtarit të Këshillit

Neni 31

(1) Anëtarit të Këshillit i ndërpritet mandati:

1) me skadimin e kohës për të cilën është zgjedhur;

2) me kërkesë të tij;

3) nëse është shkarkuar nga funksioni i gjykatësit në pajtim me ligjin;

4) nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale keqpërdorim të detyrës dhe autorizimit zyrtar në kryerjen e funksionit ose vepër tjetër penale me dënim pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj gjë që e bën të padenjë për kryerje të funksionit anëtar i Këshillit;

5) nëse anëtarit të Këshillit i konstatohet paaftësi të përhershme për kryerje të funksionit dhe

6) nëse është zgjedhur në funksion ose profesion tjetër publik.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) pika 2) e këtij neni mandati ndërpritet kur Këshilli, përkatësisht Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancë do ta miratojë dorëheqjen.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) pika 3) e këtij neni mandati i anëtarit i Këshillit ndërpritet me plotfuqishmërinë e vendimit për shkarkim të gjykatësit nga funksioni i gjykatësit.

(4) Në rastin nga paragrafi (1) pika 4) e këtij neni mandati ndërpritet me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

(5) Në rastin nga paragrafi (1) pika 5) e këtij neni mandati ndërpritet kur Këshilli në mbledhje do të përcaktojë përmbushjen e kushtit në bazë të procedurës së zbatuar paraprake, përkatësisht kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Këshillit do të përcaktojë dhe do të votojë përmbushjen e kushtit për ndërprerje të mandatit anëtar i Këshillit i zgjedhur nga Kuvendi.

(6) Në rast nga paragrafi (1) pika 6) e këtij neni mandati ndërpritet me zgjedhje në funksion ose profesion tjetër.

Largim i përkohshëm nga kryerja e funksionit anëtar i Këshillit

Neni 32

(1) Anëtari i Këshillit mund të largohet nga kryerja e funksionit anëtar i Këshillit, nëse për të është miratuar aktpadi në rastet nga neni 32 paragrafi (1) pika 4) e këtij ligj.

(2) Vendim për largim të përkohshëm nga funksioni anëtar i Këshillit miraton Këshilli me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote me ç'rast nga mbledhja dhe nga votimi përjashtohet anëtari i Këshillit kundër të cilit është ngritur procedurë.

Përfashtim i anëtarit të Këshillit

Neni 33

(1) Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në punën e Këshillit në procedura në të cilat vendoset për gjykatës, kryetar i gjykatës, kandidat për gjykatës ose kandidat për kryetar të gjykatës me të cilin është në:

- 1) Bashkësi martesore ose jashtëmartesore;
- 2) Lidhje farefisnore në linjë të drejtë deri te cilado shkallë, e në linjë anësore deri në shkallë të katërt;
- 3) Lidhje farefisnore sipas krushqisë deri në shkallë të dytë;
- 4) Raporti i të adoptuarit ose adoptuesit ose person me të cilin jeton në bashkësi të njëjtë familjare.

(2) Anëtari i Këshillit i zgjedhur nga radhët e gjykatësve nuk merr pjesë punën e Këshillit kur është ngritur procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së tij si gjykatës ose si anëtar i Këshillit.

(3) Anëtari i Këshillit është i detyruar që menjëherë ta ndërpresë punën e vet në procedurat me kompetencë të Këshillit në momentin e mësimin për ekzistimin e shkaqeve nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për atë ta njoftojë Këshillin.

(4) Anëtari i Këshillit, përveç në rastet e parapara në paragrafin (1) të këtij neni, nëse në kryerjen e funksionit të tij mëson për ekzistimin e rrethanave të cilat mund të shkaktojnë dyshim në paanshmërinë e tij, është i detyruar që menjëherë për atë ta njoftojë Këshillin, i cili do të miratojë vendim adekuat.

(5) Nëse anëtari i Këshillit nuk vepron në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, atëherë për të mund të ngrihet procedurë disiplinore.

Baza për parashtrim të kërkesës për procedurë disiplinore për anëtar të Këshillit

Neni 34

(1) Kërkesë të arsyetuar për ngritje të procedurës për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit, në Këshillin Gjyqësor mund të parashtrojnë së paku 20 gjykatës ose secili anëtarë i Këshillit Gjyqësor me të drejtë vote, nëse anëtari i Këshillit:

- ndikon mbi pavarësinë e gjykatësve dhe ushtron presion në lidhje me vendimmarrjen për lëndë të caktuara,

- e anashkalon dhe nuk e kryen funksionin e tij në punën e Këshillit,

- nëse refuzon të parashtojë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në pajtim me ligjin ose nëse të dhënat e përmbajtura në deklaratë në masë të madhe janë të pavërteta ose

- i shkel rregullat për përjashtim në situata në të cilat anëtari i Këshillit ka mësuar ose është dashur të mësojë për ekzistimin e ndonjë prej bazave për përjashtim të paraparë me këtë ligj.

(2) Anëtari i Këshillit shkarkohet nga funksioni në pajtim me bazat e paraparë në paragrafin

(1) të këtij neni nëse është kryer shkelja:

- me qëllim ose pakujdesia evedente me faj të anëtarit të Këshillit pa shkaqe të arsyeshme dhe
- shkelja ka shkakuar pasoja të rënda.

Procedura e vendimmarrjes për kërkesën për ngritjen e procedurës disiplinore për anëtar të Këshillit

Neni 35

(1) Kërkesa për ngritjen e procedurës disiplinore për anëtar të Këshillit bashkë me dëshmitë dorëzohet personalisht te anëtari i Këshillit për të cilin është parashtruar kërkesa, nëpërmjet arkivit të Këshillit ose me dërgesë të rekomanduar në adresën e shtëpisë.

(2) Nëse anëtari i Këshillit nuk gjendet në vendin e dorëzimit nga paragrafin (1) i këtij neni, i lihet njoftim me shkrim për vendin dhe kohën e marrjes së kërkesës dhe enjëjta konsiderohet si e dorëzuar me rregull.

(3) Anëtari i Këshillit mundet me shkrim t'u përgjigjet konstatimeve në kërkesë ose të paraqesë deklaratë gojore në procesverbal në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së kërkesës.

(4) Bashkë me përgjigjen ndaj kërkesës anëtari i Këshillit i dorëzon të gjitha dëshmitë në bazë të të cilave e mbështet përgjigjen ndaj kërkesës.

(5) Në afat prej dy ditësh nga kalimi i afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, kryetari i Këshillit, përkatësisht zëvendëskryetari në rastin kur kërkesa ka të bëjë me kryetarin e Këshillit, të anëtarët e Këshillit i dorëzon kërkesën për procedurë disiplinore, përgjigjen nga paragrafi (3) dhe dëshmitë nga paragrafi (4) i këtij neni, nëse të njëjtat janë dorëzuar, dhe cakton seancë ku do të debatohet për kërkesën për procedurë disiplinore të anëtarit të Këshillit.

(6) Vendimin për shkarkimin e anëtarit të Këshillit e merr Këshilli me së paku tetë vota nga anëtarët me të drejtë vote, me ç'rast për shkarkim doemos duhet të votojnë së paku dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Në marrjen e vendimit nga paragrafi (6) i këtij neni, nuk marrin pjesë anëtarët sipas funksionit, anëtari për përgjegjësinë e të cilit vendoset dhe anëtari që është parashtrues i kërkesës për ngritjen e procedurës disiplinore.

(8) Mandati i anëtarit të Këshillit pushon në ditën e marrjes së vendimit për shkarkimin e anëtarit të Këshillit.

IV. KOMPETENCA, ORGANIZIMI DHE MËNYRA E PUNËS SË KËSHILLIT

Kompetenca

Neni 36

(1) Këshilli është kompetent që:

- t'i zgjedhë dhe shkarkojë gjykatësit,
- t'i zgjedhë dhe shkarkojë kryetarët e gjykatave,
- përcaktojë ndërprerje të funksionit të gjykatësit,
- të zgjedhë dhe shkarkojë gjykatës porotë,
- ta ndjekë dhe vlerësojë punën e gjykatësve,
- të vendosë për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit,
- vendosë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës,
- të vendosë për heqje të imunitetit të gjykatësit,
- të vendosë me kërkesë për lejim të arrestimit të gjykatësit,
- të propozojë dy gjykatës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjykatësve,
- ta shqyrtojë raportin vjetor të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për qëndrimet e konstatuara parimore dhe mendimet juridike parimore për çështje me rëndësi për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve,
- të vendosë për largimin e përkohshëm të gjykatësit nga kryerja a funksionit të gjykatësit dhe anëtarit nga kryerja e funksionit anëtar i këshillit,
- ta përcaktojë numrin e vendeve të nevojshme për gjykatës nëpër gjykata,
- t'i shqyrtojë dhe vlerësojë raportet tremujore dhe vjetore për punë të gjykatave dhe të njëjtat t'i shpallë publikisht në ueb faqen e vet,
- të veprojë për parashtruesat dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjykatësve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave,

- të kujdeset për reputacionin e gjykatësve dhe besimin e qytetarëve ndaj gjyqësorit,
- të paraqesë raport vjetor për punën,
- të miratojë rregullore dhe akte tjera të përgjithshme me të cilat i rregullon punët me kompetencë të tij;

- të përcaktojë numër orientues të lëndëve që duhet t'i zgjidhë gjykatësi në nivel mujor dhe
- të kryejë edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Këshilli detyrimisht së paku njëherë në muaj mban mbledhje në të cilën diskuton veç e veç për të gjitha parashtresat dhe ankesat e parashtruara nga qytetarët dhe personat juridikë për punën e gjykatësve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave, si dhe për zgjatjen e procedurave gjyqësore dhe vendos për çdo parashtresë dhe ankesë të veçantë, më së gjati në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të tyre në Këshillin.

(3) Mbledhja e Këshillit nga paragrafi (2) i këtij neni është publike.

(4) Këshilli miraton program vjetor për punë me plan aksional më së voni deri më 15 dhjetor vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Programi vjetor për punë

Neni 37

Programi vjetor për punë të Këshillit përmban:

- masa dhe aktivitete për avancimin e pavarësisë së gjyqësorit,
- masa dhe aktivitete për rritjen e efikasitetit të gjyqësorit,
- plan për ndjekje të vazhdueshme të punës së gjykatësve,
- projeksion për vende të lira të gjykatësit dhe ruajtje të principit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- ndjekje të rekomandimeve dhe masave të propozuara nga analizat e raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatësve,

- punë tjera nga sfera e kompetencës së tij për të cilat do të vlerësojë se duhet të përfshihen në Programin vjetor për punën e Këshillit.

Puna në mbledhje

Neni 38

(1) Punët me kompetencë të vet, Këshilli i shqyrton dhe për to vendos në mbledhje.

(2) Kryetari i Këshillit i cakton mbledhjet dhe me to udhëheq.

(3) Kryetari është i detyruar që të caktojë mbledhje edhe me propozim të së paku pesë anëtarëve të Këshillit.

(4) Mbledhje mund të mbajë nëse është e pranishme shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, me të drejtë vote nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

(5) Propozimi i rendit të ditës miratohet me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm me të drejtë vote.

(6) Ftesa për mbledhje me propozimin e rendit të ditës dhe me materialet u dërgohet anëtarëve të Këshillit së paku shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes.

(7) Për shkak të punëve urgjente dhe të paprolongueshme, mbledhja e Këshillit mund të caktohet dhe mbahet edhe në afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni.

(8) Këshilli i merr vendimet me shumicën e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Publiciteti në punë

Neni 39

(1) Mbledhjet e Këshillit janë publike.

(2) Publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjykatësit ose kandidatit për gjykatës. Për përjashtim të publikut nga mbledhjet, Këshilli vendos me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

(3) Në rast kur Këshilli ka vendosur për përjashtim të publikut nga mbledhja, kryetari i Këshillit është i detyruar që ta njoftojë publikun për shkaqet për përjashtim të publikut dhe në rast nëse në mbledhjen e njëjtë miraton vendim me votim, votimi për vendimin është publik.

(4) Kur Këshilli vendos për zgjedhje të kryetarit të gjykatës ose zgjedhje të gjykatësit publiku nuk mund të përjashtohet në asnjë rast.

(5) Këshilli përpilon procesverbal për vendimin nga paragrafi (4) i këtij neni dhe të njëjtin e shpall publikisht në ueb faqen e Këshillit.

(6) Për punën e mbledhjes së Këshillit mbahet procesverbal dhe bëhet incizim tonik. Procesverbali i miratuar publikohet në ueb faqen e Këshillit.

Kryetari i Këshillit

Neni 40

Kryetari i Këshillit:

- e prezanton Këshillin,
- kryeson dhe udhëheq me mbledhjet,
- merr pjesë në punën dhe në vendimarrjen e Këshillit,
- i nënshkruan vendimet, propozimet, aktvendimet dhe aktet tjera të Këshillit dhe kujdeset për zbatimin e tyre dhe
- kujdeset për zbatimin e Rregullores së Këshillit dhe kryen edhe punë tjera të caktuara me ligj dhe Rregullore.

Barazia e anëtarëve të Këshillit

Neni 41

Anëtarët e Këshillit me të drejtë vote në kryerjen e funksionit anëtar i Këshillit janë të barabartë në të drejtat dhe obligimet.

Ndalim për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

Neni 42

Anëtari i Këshillit derisa zgjat mandati i tij, nuk mund të zgjidhet për gjykatës, për gjykatës në gjykatën më të lartë, për kryetar të gjykatës ose për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarit të Këshillit

Neni 43

(1) Anëtari i Këshillit me të drejtë vote i ka të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë në vijim:

- merr pjesë në punën dhe në vendimarrjen e Këshillit,
- jep iniciativa, propozime dhe mendime për çështje me kompetentë të Këshillit,

- merr pjesë në punën e trupave punues të Këshillit në të cilin është zgjedhur,
- me përjashtim të Këshillit realizon këqyrje në punën e gjykatësit dhe ndërmerr veprime tjera dhe për atë i paraqet raport Këshillit,
- është përgjegjës për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit në lidhje me kryerjen e funksionit në Këshillin dhe
- kryen edhe punë tjera të caktuara me këtë ligj.

(2) Ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Gjykatës Supreme si anëtarë të Këshillit sipas funksionit i kanë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e njëjta, si edhe anëtarët me të drejtë vote nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç në rastet e parapara me këtë ligj.

Rregullore për punën e Këshillit

Neni 44

(1) Këshilli miraton Rregullore për punë me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

(2) Me Rregulloren për punën e Këshillit rregullohet procedura dhe mënyra e punës së Këshillit, dhe çështjet tjera në kompetencë të Këshillit.

(3) Rregullorja për punë botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. ZGJEDHJA, NDËRPRERJA DHE SHKARKIMI I GJYKATËSIT DHE GJYKATËSIT-POROTË

Përcaktimi i vendeve të lira të gjykatësve në gjykatat themelore

Neni 45

(1) Këshilli me vendim në bazë të analizës e përcakton numrin e vendeve të lira të gjykatësve për gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e marrë parasysh numrin e përgjithshëm të vendeve të lira për gjykatës në gjykatat themelore, si dhe projeksionin për nevojat për vendet që do të plotësohen pas përfundimit të trajnimit fillestar.

(2) Vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni Këshilli e miraton me së paku shtatë anëtarë me të drejtë vote dhe ia dorëzon Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë më së voni deri më 31 mars në vitin në të cilin është miratuar vendimi.

Shpallja e zgjedhjes për gjykatës

Neni 46

(1) Këshilli miraton vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhje të gjykatësit menjëherë pas zbrazjes së vendit të gjykatësit, ose pas nevojës së konstatuar për vendin e gjykatësit.

(2) Në vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhje të gjykatësit ceket edhe specializimi i nevojshëm (fusha penale, civile, ekonomike, administrative ose fushë tjetër nga fushëveprimi i punës së gjykatës) për plotësimin e vendit të zbrazët të gjykatësit, e në pajtim me kërkesën e dorëzuar paraprakisht nga ana e gjykatës në Këshillin me të cilën kërkohet plotësimi i vendit të gjykatësit.

(3) Konkursi botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe së paku në dy gazeta ditore nga të cilat njëra në gjuhë tjetër të ndryshme nga gjuha maqedonase që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zgjat 15 ditë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Zgjedhja e gjykatësit të gjykatës themelore

Neni 47

(1) Këshilli zgjedh gjykatës të gjykatës themelore nga lista e kandidatëve, të dorëzuar nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë që janë paraqitur në konkurs, duke i marrë parasysh vitin e mbarimit të trajnimit dhe suksesin e arritur, si dhe rezultatin nga intervista e kryer nga Këshilli.

(2) Këshilli kryen uintervistë të kandidatëve duke i vlerësuar kompetencat e tyre personale dhe sociale, me ç'rast për intervistën e kryer kandidati mund të fitojë më së shumti 10% të pikave të përgjithshme.

(3) Këshilli e zgjedh për gjykatës kandidatin më të mirë të ranguar sipas kritereve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Këshilli me akt nënligjor e përcakton mënyrën e rangimit sipas kritereve nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e kryerjes së intervistës së kandidatëve.

(5) Aktin nënligjor nga paragrafi (4) i këtij neni e miraton Këshilli me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

(6) Këshilli mund të zgjedhë gjykatës të një gjykate themelore që është paraqitur në konkurs për gjykatës të gjykatës tjetër themelore, nëse në konkurs nuk është paraqitur kandidati nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.

Kritere për zgjedhje të gjykatës në gjykatë më të lartë

Neni 48

(1) Këshilli zgjedh gjykatës në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Administrative, Gjykatën e Lartë Administrative dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga kandidatët e paraqitur në konkurs që i përmbushin kushtet dhe kriteret e parapara në Ligjin për gjykatat dhe në këtë ligj në mënyrë që kandidatët e paraqitur i rangon sipas specializimit të nevojshëm për plotësimin e vendit për gjykatës.

(2) Këshilli për gjykatës do ta zgjedhë personin i cili ka cilësi më të larta profesionale, i cili gëzon autoritet në kryerjen e funksionit të gjykatësit, e në bazë të kritereve vijuese:

1) njohuria profesionale dhe specializimi në profesion dhe pjesëmarrja në trajnimin e vazhdueshëm;

2) nota pozitive në punë;

3) aftësia për shprehje gojore dhe me shkrim, që shihet përmes vendimeve të përpiluara dhe veprimit profesional gjyqësor;

4) ndërmarrja e punës plotësuese në kryerjen e funksionit të gjykatësit me pjesëmarrje në zgjidhjen e lëndëve të mbetura;

5) ndërmarrja e punës plotësuese gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor përmes mentorimit, edukimit dhe ngjashëm dhe

6) gjatësia e stazhit të gjykatësit.

(3) Nëse kandidati është nga radhët e gjykatësve, Këshilli merr mendim nga gjykat.

(4) Kryetari i gjykatës në bazë të mbledhjes së mbajtur të gjykatësve e dorëzon mendimin në Këshill.

(5) Mënyrën e rangimit të kandidatëve e rregullon Këshilli me akt nënligjor.

(6) Rangimin e kandidatëve e kryen komisioni i formuar nga tre anëtarë të Këshillit me të drejtë vote, të zgjedhur me short.

Vendimi për zgjedhje të gjykatësit

Neni 49

(1) Për zgjedhjen e gjykatësit, Këshilli diskuton dhe vendos në mbledhje në të cilën janë të pranishme së paku shtatë vota të anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

(2) Gjykatës zgjidhet kandidati i cili ka fituar së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

(3) Çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote është i detyruar gojarisht në mbledhje të Këshillit ta arsyetojë vendimin e vet për zgjedhje të gjykatësit.

(4) Këshilli është i detyruar që ta njoftojë me shkrim çdo kandidat për vendimin për zgjedhje të gjykatësit.

(5) Kandidati i cili nuk është zgjedhur gjykatës ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit në Këshillin për ankesën në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në zgjedhjen e gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave

Neni 50

(1) Kur Këshilli zgjedh gjykatës dhe kryetar të gjykatës themelore dhe gjykatës së apelit që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, vendos në pajtim me nenin 49 të këtij ligji, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Kur Këshilli zgjedh kryetar dhe gjykatës të Gjykatës administrative, Gjykatës së Lartë Administrative dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendos në pajtim me nenin 49 të këtij ligji, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Zgjedhja e kryetarit të gjykatës

Neni 51

(1) Këshilli zgjedh kryetar të gjykatës nga kandidatët e paraqitur gjykatës në shpalljen për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës me së paku tetë anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

(2) Këshilli për kryetar do të zgjedh personin që i përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin për gjykata.

(3) Secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote ka për detyrë publikisht në mbledhjen e Këshillit ta arsyetojë vendimin e vet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës.

(4) Këshilli ka për detyrë me shkrim ta njoftojë çdo kandidat për vendimin për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës.

(5) Kandidati që nuk është zgjedhur kryetar i gjykatës ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit të Këshilli për vendimmarrje për ankesa te Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpallja e sërishme e zgjedhjes

Neni 52

Nëse pas procedurës së zbatuar për zgjedhjen e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, Këshilli përcakton se nuk ka kandidat të paraqitur ose të gjithë kandidatët e paraqitur janë vlerësuar me notë negative, do të miratojë vendim për shpalljen e sërishme të zgjedhjes së gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës.

Zgjedhja dhe shkarkimi i gjykatësve - porotë

Neni 53

(1) Këshilli zgjedh dhe shkarkon gjykatës - porotë me propozim të kryetarit të gjykatës së apelit dhe gjykatës themelore kompetente.

(2) Këshilli e përcakton numrin e gjykatësve - porotë me propozim të kryetarit të gjykatës për të cilën zgjidhen gjykatësit - porotë.

(3) Kur Këshilli zgjedh gjykatës - porotë në gjykatë që gjendet në zonën e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit

Neni 54

Këshilli me aktvendim do të përcaktojë ndërprerjen e funksionit të gjykatësit, kur është përmbushur njëra nga bazat e përcaktuara me Kushtetutë, në mënyrën e caktuar me këtë ligj, edhe atë:

- 1) me kërkesë të gjykatësit;
- 2) nëse përherë e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit;
- 3) nëse i përmbush kushtet për pensionin e pleqërisë;
- 4) nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj ose i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
- 5) nëse zgjidhet ose emërohet në funksion tjetër publik, përveç në rastet e pushimit të përcaktuara me ligj, në ditën e zgjidhjes ose emërimit në funksionin ose profesionin tjetër publik.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit me kërkesë të gjykatësit

Neni 55

Këshilli miraton aktvendim për ndërprerjen e funksionit të gjykatësit, kur vetë do ta kërkojë këtë, posaçërisht pa i shqyrtuar shkaqet e kërkesës.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e tij

Neni 56

(1) Këshilli me aktvendim do të përcaktojë ndërprerjen e funksionit të gjykatësit, për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit.

(2) Humbja e përhershme e aftësisë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit përcaktohet në bazë të dokumentacionit me konstatim, vlerësim dhe mendim të komisionit shëndetësor kompetent.

(3) Procedurën për përcaktimin e humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit, Këshilli e ngre me detyrë zyrtare kur vetë do të vijë në njohurinë e tillë, ose kur iniciativë të tillë do të jap kryetari i gjykatës në të cilën gjykatësi e ushtron funksionin ose kryetari i gjykatës më të lartë ose mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Procedura për ngritjen dhe përcaktimin e humbjes së përhershme të aftësisë, më afër rregullohet me rregullore që e miraton Këshilli.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit me përmbushjen e kushteve për pensionin e pleqërisë

Neni 57

(1) Funksioni i gjykatësit ndërpritet me përmbushjen e kushteve për pensionin e pleqërisë në pajtim me ligjin, me ç'rast gjykatësi mund ta vazhdojë mandatin në pajtim me rregullat për marrëdhënie pune me dorëzimin e deklaratës te Këshilli Gjyqësor.

(2) Këshilli ndërprerjen, përkatësisht vazhdimin e funksionit të gjykatësit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni me aktvendim e konstaton në mbledhjen e parë të ardhshme.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit për shkak të kryerjes së veprës penale ose kundërvajtjes

Neni 58

(1) Këshilli me aktvendim do të përcaktojë ndërprerjen e funksionit të gjykatësit kur gjykatësi është dënuar për kryerjen e veprës penale me dënim pakusht me burg prej së paku gjashtë muaj ose i është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilën është shqiptuar ky dënim, përkatësisht kundërvajtje.

(2) Gjykata e shkallës së parë që e ka miratuar vendimin nga paragrafi (1) të këtij neni pa prolongim do të dorëzojë te Këshilli ekzemplar të aktgjykimit.

Ndërprerja e funksionit të gjykatësit për shkak të zgjedhjes ose emërimit në funksionin tjetër publik

Neni 59

(1) Këshilli me aktvendim do të përcaktojë ndërprerjen e funksionit të gjykatësit kur është zgjedhur ose emëruar në funksionin tjetër publik, përveç në rast kur me ligj parashihet pushimi i funksionit të gjykatësit në ditën e zgjedhjes, përkatësisht emërimit.

(2) Organi i cili e ka zgjedhur, përkatësisht emëruar gjykatësin në funksionin tjetër publik ka për detyrë që Këshillit menjëherë t'ia dorëzojë aktin për emërim, përkatësisht zgjedhje.

Bazat për shkarkimin e gjykatësit

Neni 60

Gjykatësi shkarkohet nga funksioni i gjykatësit:

1) për shkak të kryerjes së shkeljes së rëndë disiplinore të përcaktuar me ligj që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit dhe

2) për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pavetëdijshëm të funksionit të gjykatësit, të përcaktuar me ligj.

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës

Neni 61

(1) Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës (në tekstin e mëtutjeshëm: procedura) ngrihet në afat prej gjashtë muaj nga dita e kuptimit të shkeljes së bërë, por jo më vonë se tre vjet nga dita e kryerjes së shkeljes.

(2) Procedura është urgjente dhe me karakter konfidencial, kryhet pa praninë e publikut dhe me respektimin e reputacionit dhe dinjitetit të gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës gjatë së cilës mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale të gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Me kërkesë të gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës, Këshilli do të vendos procedura të jetë publike.

(4) Me kërkesë të gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës, në mbledhje mund të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Shoqatës së Gjykatësve.

Kërkesa për ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës

Neni 62

(1) Kërkesë e arsyetuar për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës (në tekstin e mëtuftjeshëm: kërkesa) dorëzohet te Këshilli dhe përmban: emrin dhe mbiemrin e gjykatësit ose të kryetarit të gjykatës, adresën dhe vendbanimin, në cilën gjykatë e kryen funksionin, përshkrimin e shkeljes, emrin ligjor të shkeljes me theksimin e dispozitave të Ligjit për gjykatat dhe propozim dëshmi që duhet të nxirren në diskutimin.

(2) Me kërkesën dorëzohen edhe dëshmitë në të cilat bazohet kërkesa.

Komisioni i raportuesve

Neni 63

(1) Pas marrjes së kërkesës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, Këshilli i anëtarëve me të drejtë vote me short formon Komision të raportuesve (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komisioni) të përbërë nga tre anëtarë nga të cilët dy janë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga gjykatësit, e njëri është nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kryetari i Komisionit zgjidhet me short nga radhët e anëtarëve të Komisionit.

(2) Anëtari i Këshillit që është parashtrues i kërkesës, nuk mund të jetë anëtar i Komisionit nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Kur Këshilli përcakton përgjegjësinë e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës i cili u takon bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni, një anëtar doemos duhet të jetë pjesëtar nga bashkësitë të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(4) Komisioni e hedh poshtë kërkesën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës nëse kërkesë është:

- jo në kohën e duhur,
- e paplotë ose
- dukshëm e pabazuar, përkatësisht ka të bëjë me fakte që tanimë kanë qenë lëndë e shqyrtimit nga gjykata më e lartë në procedurë për këshillë juridike ose kanë mundur të jenë lëndë e shqyrtimit nga gjykata më e lartë, por nuk janë ngritur me këshillë juridike.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, procedura e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës përfundon me aktvendim të Komisionit.

(6) Komisioni vendos me së paku dy vota, përveç për vendimin për hedhje poshtë të kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni, të cilin e merr me konsenzus, përkatësisht me tri vota.

(7) Nëse Komisioni nuk e hedh poshtë kërkesën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit, respektivisht kryetarit të gjykatës, do t'i dorëzojë Këshillit njoftim për gjendjen e përcaktuar faktike, që është i obliguar të vendosë në afat prej shtatë ditësh nga dita e dorëzimit të njoftimit për ndërprerjen ose vazhdimin e procedurës.

(8) Nëse Këshilli vendos për vazhdimin e procedurës, Komisioni obligohet t'i grumbullojë të gjitha informatat e nevojshme dhe të përgatisë raport në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Grumbullimi i të dhënave dhe dëshmime

Neni 64

(1) Komisioni grumbullon të dhëna dhe dëshmi të cilat janë me interes për përcaktimin e gjendjes në lidhje me kërkesën.

(2) Nëse të dhënat dhe dëshmitë nga paragrafi (1) i këtij neni gjenden te organi shtetëror, organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale ose te personi fizik ose juridik të cilit i është besuar kryerja e autorizimeve publike, të njëjtit janë të detyruar pa kompensim t'i dorëzojnë te Këshilli në afatin e caktuar në kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni.

Dorëzimi

Neni 65

(1) Komisioni e dorëzon kërkesën dhe dëshmitë personalisht për gjykatësin ose kryetarin e gjyqit kundër të cilit është parashtruar, nëpërmjet arkivit të gjyqit i cili e kryen funksionin e gjykatësit ose me dërgesë e rekomanduar në adresë të shtëpisë.

(2) Nëse gjykatësi nuk haset në vendin e dorëzimit nga paragrafi (1) i këtij neni i lihet njoftim me shkrim për vendin dhe kohën e marrjes së kërkesës, dhe ky konsiderohet si dorëzim i rregullt.

(3) Gjykatësi ose kryetari i gjyqit mundet me shkrim të përgjigjet në citimet e kërkesës ose të japë deklaratë me gojë në procesverbal në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së kërkesës.

(4) Gjykatësi ose kryetari i gjyqit kundër të cilit është parashtruar kërkesa ka të drejtë të avokatit të cilin vet e njofton dhe e siguron për debat.

(5) Së bashku me përgjigjen e kërkesës gjykatësi ose kryetari i gjyqit i dorëzon të gjitha dëshmitë në bazë të së cilave e themelon përgjigjen e vet të kërkesës.

(6) Gjykatësi ose kryetari i gjyqit në përgjigjen e kërkesës është i detyruar ta theksojë adresën në të cilën do t'i dorëzohen letrat gjatë procedurës me shkrim me dërgesë të rekomanduar, si dhe adresën elektronike në të cilën letrat do t'i dorëzohen në formë elektronike.

(7) Nëse gjykatësi ose kryetari i gjyqit nuk gjendet në adresën e cekur në përgjigje të kërkesës ku duhet të bëhet dorëzimi i letrës, dorëzuesi do të lë njoftim me shkrim për shkak të marrjes së letrës me të cilën njoftohet të vijë në ditën e caktuar në hapësirën e caktuar të Këshillit për pranim të letrës. Nëse gjykatësi ose kryetari i gjyqit nuk vepron sipas njoftimit konsiderohet se dorëzimi është bërë në ditën dhe orën e cekur në njoftim.

(8) Dorëzimi në formë elektronike bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore.

Debati për kërkesën

Neni 66

(1) Komisioni cakton debat në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së përgjigjes së kërkesës nga gjykatësi ose kryetari i gjykatës. Komisioni punon në përbërje të plotë dhe me të udhëheq kryetari.

(2) Në debat ftohet gjykatësi, respektivisht kryetari i gjykatës.

(3) Nëse gjykatësi ose kryetari i gjykatës i ftuar me rregull nuk merr pjesë, e mungesën nuk e arsyeton debati do të mbahet.

(4) Në debat nxirren dëshmi të propozuara nga parashtruesi i kërkesës, gjykatësi, respektivisht kryetari i gjykatës, si dhe dëshmitë e marra nga komisioni.

(5) Gjykatësi, respektivisht kryetari i gjykatës ka të drejtë gojarisht në procesverbal ose me shkrim në afat prej tri ditësh të deklarohet për të gjitha dëshmitë e parashtruara në debat.

(6) Për dëshmitë e marra në debat përpilohet procesverbal. Procesverbalin e mban personi nga radhët e shërbimit profesional të Këshillit.

(7) Procesverbali veçanërisht përmban të dhëna për: ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së debatit, kryetarin dhe anëtarët e komisionit dhe personin që e mban procesverbalin, emrat e personave të pranishëm, deklaratën e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, respektivisht të mbrojtësit të tij dhe dëshmitë që nxirren. Procesverbalin e nënshkruajnë parashtruesi i kërkesës, gjykatësi ose kryetari i gjykatës, respektivisht mbrojtësi i tij, Komisioni dhe personi që e mban procesverbalin.

(8) Nëse njëri nga personat e theksuar në paragrafin (7) të këtij neni nuk e nënshkruan procesverbalin, kjo do të evidentohet te i njëjti.

(9) Për rrjedhën e debatit krahas procesverbalit kryhet edhe incizim i zërit.

(10) Procesverbali, respektivisht incizimi i zërit nga paragrafi (9) i këtij neni, në afat prej 48 orësh do të shikohen dhe i bashkëngjiten procesverbalit, bashkë me përshkrimin e incizimit të zërit.

Raporti i Komisionit

Neni 67

(1) Komisioni në afat prej 15 ditësh nga dita e mbarimit të debatit parashtron Raport për gjendjen e konstatuar për kërkesën te Këshilli.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet t'i përmbajë të gjitha shkresat dhe aktet që cilat gjatë procedurës Komisioni i ka pasur në disponim, prononcimin e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, si dhe përshkrimin e veprimeve të zbatuara.

(3) Të gjitha shkresat për lëndën doemos duhet të jenë të arritshme për anëtarët e Këshillit.

Diskutimi para Këshillit

Neni 68

(1) Në diskutimin para Këshillit kryetari i Komisionit e arsyeton Raportin.

(2) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit marrin pjesë në diskutim dhe votim për vendimin.

(3) Nëse anëtari i Këshillit është parashtrues i kërkesës ai nuk merr pjesë në diskutim para Këshillit dhe përjashtohet nga votimi për vendimin përfundimtar.

(4) Duke vendosur për raportin, Këshilli mundet përkohësisht ta largojë gjykatësin ose kryetarin e gjykatës nga kryerja e funksionit të gjykatësit, sipas ligjit për gjykata.

(5) Nëse gjykatësi, përkatësisht kryetari i gjykatës kundër të cilit është ngritur procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë, gjatë procedurës parashtron kërkesë për ndërprerjen e funksionit të gjykatësit, Këshilli do të konstatojë ndërprerjen e funksionit të gjykatësit dhe do të zgjasë procedurën deri në marrjen e vendimit përfundimtar i cili do të jetë pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore të gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës.

Procedura për vendimmarrje për propozim-vendimin për shqiptimin e masës disiplinore

Neni 69

(1) Këshilli në mbledhje debaton për Raportin e komisionit dhe pas përfundimit të debatit fillimisht vendos për ndërprerjen e procedurës, nëse konstaton se nuk ka bazë për përgjegjësi, me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

(2) Në rastin nga paragrafi (1), vendimi për largim të përkohshëm nga kryerja e funksionit të gjykatësit lihet jashtë fuqie.

(3) Nëse Këshilli nuk miraton vendim për ndërprerjen e procedurës, respektivisht konstaton se gjykatësi ose kryetari i gjykatës ka kryer shkelje më të rëndë disiplinore ose në mënyrë të papërgjegjshme ose joprofesionale e ka kryer funksionin e gjykatësit, në kushte të përcaktuara me ligj, vendos për shkarkimin e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

(4) Nëse Këshilli nuk e ndërpren procedurën ose nuk merr vendim për shkarkim, respektivisht konstaton se ekziston përgjegjësi e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës për shkelje disiplinore të kryer, kryen votim për shqiptim të masës disiplinore, duke filluar nga më e rënda te më e lehta, me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

(5) Me miratimin e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore votimi ndërpritet.

(6) Me miratimin e vendimit për shkarkim, gjykatësi ose kryetari i gjykatës përkohësisht largohet nga kryerja e funksionit të gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës.

Vendosja për raportin e komisionit

Neni 70

Nëse Këshilli gjatë diskutimit për raportin në Komision me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote vlerëson se është i nevojshëm përpunimi plotësues i lëndës, mundet shkresat për lëndën t'ia kthejë Komisionit në përpunim plotësues më së shumti njëherë, me udhëzime dhe drejtime i cili është i detyruar që raportin për lëndën me të gjitha veprimet e zbatuara plotësuese t'i dorëzojë te Këshilli në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit.

Dorëzimin e vendimit

Neni 71

(1) Vendimi nga neni 69 i këtij ligji përpilohet në afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit dhe në mënyrë të detyrueshme përmban hyrje, përmbajtje, arsyetim dhe këshillë juridike.

(2) Ekzemplar nga vendimi i dorëzohet gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës, parashtruesit të kërkesës dhe kryetarit të gjykatës në të cilën gjykatësi e kryen funksionin, përkatësisht kryetarit të gjykatës së drejtëpërdrejtë më të lartë.

(3) Dorëzimi i vendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, kryhet në pajtim me nenin 65 të këtij ligji.

E drejta për ankesë

Neni 72

(1) Të drejtë ankese te Këshilli për vendimmarrje për ankesë pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e më tutjeshëm: Këshilli për Ankesë) kundër vendimit të Këshillit, ka vetëm gjykatësi përkatësisht kryetari i gjykatës për të cilin është ngritur procedura për përcaktimin e përgjegjësisë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(2) Këshilli për Ankesë është i përbërë prej nëntë anëtarëve, prej të cilëve tre gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga një gjykatës nga gjykatat e apelit dhe dy gjykatës nga gjykata nga e cila është gjykatësi kundër të cilit është mbajtur procedura. Anëtarët zgjidhen publikisht me short në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht mbledhjen e të gjithë gjykatësve të gjykatës përkatëse, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(3) Këshilli për Ankesë më së voni në afat prej 30 ditësh nga formimi i tij vendos për ankesën, duke e vlerësuar ligjshmërinë e procedurës.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, Këshilli për Ankesë mund ta konstatojë apo ta anulojë aktvendimin e Këshillit në rast të shkeljes së rëndë të dispozitave të përgjegjësi të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës.

(5) Nëse Këshilli për Ankesë e anulon aktvendimin, Këshilli do ta përsërisë procedurën, detyrimisht duke i respektuar udhëzimet e Këshillit për Ankesë dhe do të marrë vendim dhe të njëjtin publikisht do ta shpallë në ueb-faqen e vet.

(6) Kundër vendimit nga paragrafi (5) i këtij neni nuk lejohet ankesë ose padi.

(7) Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatësi, respektivisht kryetari i gjykatës pjesëmarrës në procedurën para Këshillit nuk mund të jetë anëtar i Këshillit për Ankesë nga paragrafi (2) i këtij neni.

Përsëritja e procedurës me rastin e aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strazburg

Neni 73

(1) Kur Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut do të përcaktojë shkeljen e të drejtës së njeriut ose lirive themelore të parapara me Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe lirive themelore dhe Protokolet plotësuese të Konventës, të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut i ka ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në procedurë para Këshillit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjykatësi ose kryetari i gjykatës e drejta e të cilit është shkelur në procedurat, mund në afat prej 30 ditësh, por më së voni në afat prej tre vjetësh nga përfundimi i aktgjykimit në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut të parashtrojë kërkesë te Këshilli për përsëritjen e procedurës.

(2) Për kërkesën e parashtruar Këshilli e njofton Komisionin Ndërrësor për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, në pajtim me Ligjin për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

(3) Këshilli është i detyruar në procedurën e përsëritur t'i respektojë qëndrimet juridike të shprehura në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut me të cilin është përcaktuar shkelja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

(4) Këshilli në pajtim me nenin 25 të Ligjit për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut mund ta përsërisë procedurën për mënjanimin e shkeljes dhe pasojave të cilat janë shkaktuar nga shkelja.

(5) Këshilli nga radhat e veta në afat prej 15 ditësh formon Komision nga kryetari dhe dy anëtarë për veprim sipas kërkesës së parashtruar për përsëritjen e procedurës në të cilin nuk mund të jenë anëtarët e Këshillit të cilët janë anëtarë të Komisionit ndërrësor për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

(6) Komisioni vlerëson nëse kërkesa e parashtruar është në kohë, e plotë dhe e lejueshme.

(7) Nëse kërkesa është jo e plotë, jo në kohë dhe jo e lejueshme, Komisioni do t'i propozojë Këshillit ta refuzojë.

(8) Nëse Komisioni përcakton se kërkesa është në kohë, e plotë dhe e lejueshme Komisioni lëndën e dorëzon për veprim të mëtutjeshëm te Këshilli i cili lëndën më së voni në afat prej tri ditësh e dorëzon për veprim kompetent te Këshilli për Ankesa pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Këshilli për Ankesë është i detyruar në afat prej 15 ditësh nga pranimi i lëndës të veprojë dhe ta shfuqizojë vendimin e vet dhe vendimin e Këshillit, duke u nisur nga qëndrimet juridike të shprehura në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut me të cilin është përcaktuar shkelja dhe lënda menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tri ditësh, ta kthejë te Këshilli për veprim të sërishëm.

(10) Procedura e përsëritur në pjesën e shkeljes së përcaktuar mbahet në pajtim me dispozitat e këtij ligji për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, në të cilën mund të propozohen dhe paraqiten dëshmi të reja.

(11) Kundër vendimit të miratuar në procedurën e përsëritur, pala e pakënaqur ka të drejtë për ankesë te Këshilli për Ankesa në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit.

E drejta për gjykim të drejtë

Neni 74

Gjatë procedurës para Këshillit, gjykatësi ose kryetari i gjykatës kundër të cilit mbahet procedura ka të drejtë në gjykim të drejtë në pajtim me garancitë e përcaktuara në nenin 6 të Konventës evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kritere dhe procedura për ndjekje dhe vlerësimi i punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës

Neni 75

(1) Ndjekja e punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës bëhet nëpërmjet vlerësimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm.

(2) Gjykatësi vlerësohet sipas rezultateve të përgjithshme nga suksesi i arritur në punën nëpërmjet kritereve të përcaktuara kualitative dhe kuantitative në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Qëllimi i ndjekjes dhe vlerësimit

Neni 76

(1) Qëllimi i ndjekjes dhe vlerësimit të punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës është afirmim i gjyqësisë si pushtet i mëvetësishëm dhe i pavarur, përf forcimin e motivimit personal të gjykatësve, sigurimi i zhvillimit të mëtejshëm profesional të gjykatësve në bazë të aftësive të tyre personale dhe profesionale pa ndonjë ndikim, si dhe për përf forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatësve gjatë kryerjes së funksionit gjykatës.

(2) Ndjekja dhe vlerësimi i punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës realizohet pa u shkelur pavarësia dhe mëvetësia e gjykatësit në kryerjen e funksionit gjykatës dhe kryetarit të gjykatës.

Vlerësimi i rregullt dhe i jashtëzakonshëm

Neni 77

(1) Vlerësimi i rregullt i gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës bëhet një herë në katër vjet, përfundimisht në fund të qershorit në vitin rrjedhës, për punën e gjykatësve dhe kryetarit të gjykatës në katër vitet paraprake.

(2) Vlerësimi i jashtëzakonshëm i punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës kryhet në rast kur gjykatësi konkurren për zgjedhje të gjykatësit në gjykatë tjetër në gjykatë më të lartë, për zgjedhje të kryetarit të gjykatës ose për anëtar të Këshillit.

(3) Nëse gjykatësi ose kryetari i gjykatës konkurrojnë për gjykatës në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës, në vitin rrjedhës për vitin paraprak për të cilën veçmë janë të vlerësuar nëpërmjet vlerësimit të rregullt, në atë rast nuk bëhet vlerësimi i tyre i jashtëzakonshëm.

Metoda për ndjekje dhe vlerësim

Neni 78

(1) Vlerësimi i punës së gjykatësit bëhet në bazë të rezultateve të përgjithshme nëpërmjet vlerësimit kuantitativ dhe kualitativ të punës së gjykatësit.

(2) Këshilli e vërteton formën dhe përmbajtjen e Formularit në të cilin janë të përmbajtura të dhëna dhe informata për punën e gjykatësve dhe për punën e kryetarit të gjykatës, në pajtim me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, në të cilin futen të dhënat për punën e gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës që plotësohen një herë në muaj.

(3) Pjesë përbërëse e Formularit nga paragrafi (2) i këtij neni është udhëzimi për mënyrën e plotësimit të formularit i përgatitur nga Këshilli.

Elementet për llogaritjen e vlerësimit

Neni 79

(1) Si bazë për llogaritjen e vlerësimit për punën e gjykatësit merret përmbledhja e rezultateve të marra nga kriteret kualitative dhe kuantitative. Kriteret kualitative në raport të kuantitativave janë në raport 60 % kundrejt 40 % gjatë formimit të vlerësimit përfundimtar.

(2) Gjatë llogaritjes së vlerësimit për punën e gjykatësit merret parasysh koha efektive e punës. Mënyrën e llogaritjes së kohës efektive të punës së gjykatësit e përcakton Këshilli dhe e njëjta shpallet në ueb faqen e Këshillit.

(3) Për kriteret kualitative gjykatësi mund të marrë maksimum 120 pikë, ndërsa për kriteret kuantitative mund të marrë maksimum 80 pikë.

Kriteret kualitative për punën e gjykatësit

Neni 80

Kriteret kualitative për vlerësim të punës së gjykatësit janë:

- kualiteti i mbajtjes së procedurës gjyqësore në të cilat vlerësohet: aftësia për argumentim, përgatitja për mbajtjen e debatit, përpilimin e procesverbalit dhe dëgjimin e palëve, përgatitja për miratimin e vendimeve në proces si dhe aftësinë për zgjidhjen e konflikteve.

- kualiteti i veprimit azhurnues për lëndë gjyqësore në raport të: respektimit të afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve në proces në procedurë, respektimin e afateve ligjore për miratimin, shpalljen dhe përgatitjen e vendimeve, kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore dhe

- kualitetin e punës së gjykatësit në pjesën e numrit të vendimeve të shfuqizuara për shkak të shkeljeve të rëndësishme të procedurës në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura normuese.

Përcaktimi i plotësimit të kriterëve kualitative

Neni 81

(1) Kualiteti i udhëheqjes së procedurave gjyqësore vërtetohet nëpërmjet kontrollit në pesë lëndë sipas zgjedhjes së rastësishme nga sistemi i amotrituar kompjuterik për menaxhim me lëndët gjyqësore dhe pesë lëndë të përcaktuara nga gjykatësi, në periudhën e vlerësimit, nga komisionet.

(2) Kualiteti i veprimit të azhurnuar sipas lëndëve gjyqësore vlerësohet nëpërmjet kontrollit të të dhënave nga sistemi i amortizuar kompjuterik për menaxhim me lëndët gjyqësore.

(3) Kontrollin nga paragrafi (1) i këtij neni për vlerësim të punës së kandidatit për gjykatës e kryejnë Komisionet prej pesë anëtarëve gjykatës nga të gjitha gjykatat e apelit, përkatësisht drejtpërdrejtë nga gjykata më e lartë.

(4) Komisionet nga paragrafi (3) i këtij neni për vlerësimin e punës së gjykatësve i formon Këshilli, me zgjedhje të rastësishme, në mënyrën e rregulluar me akte nënligjore të cilin e miraton Këshilli.

Puna e Komisionit

Neni 82

(1) Çdo anëtar i komisionit nga neni 81 i këtij ligji e vlerëson punën e gjykatësit në secilën lëndë veç e veç, ndërsa vlerësimi përfundimtar merret si vlerë mesatare e të gjitha notave veç e veç për të gjitha lëndët nga çdo anëtar.

(2) Komisioni dorëzon te Këshilli një vlerësim mesatar të arsyetuar.

(3) Vlerësimi bëhet me nota prej 1 deri në 10 me ç'rast 10 është nota më e lartë.

(4) Formularët dhe metodologjia për vlerësim nga çdo anëtar i miraton Këshilli në bazë të mendimit nga mbedhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pikat maksimale të kriterëve kualitative

Neni 83

Për kriteret kualitative nga neni 80 i këtij ligji gjykatësi mund të marrë maksimum 120 pikë.

Vlerësimi me pikë i kriterëve kualitative

Neni 84

(1) Kualiteti i udhëheqjes së procedurës vlerësohet me pikë në pajtim me këtë tabelë:

Nota mesatare nga Komisioni për kualitetin e udhëheqjes së procedurës	Pikët
Prej 8-10	60
Prej 5-8	40
Prej 3-5	25
Nën 3	0

(2) Kualiteti në veprim azhurnues për lëndë gjyqësore, vlerësohet me pikë në pajtim me këtë tabelë:

Përqindja e afateve të respektuara	Pikët
- afate të respektuara në më shumë se 90% deri 100 % të lëndëve	35
- afate të respektuara në më shumë se 70% deri 90 % të lëndëve	25
- afate të respektuara në më shumë se 50% deri 70 % të lëndëve	15
- afate të respektuara në më pak se 50% të lëndëve	0

(3) Kualiteti i punës së gjykatësit në pjesën e numrit të vendimeve të shfuqizuara për shkak të shkeljeve të rëndësishme të procedurës në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura në periudhën në të cilën vlerësohet, vlerësohet me pike në pajtim me këtë tabelë:

Përqindja e vendimeve të shfuqizuara në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve të normuara	Pikët
Deri 5 %	25
Prej 5 % deri 10 %	20
Prej 10 % deri 15 %	15
Prej 15 % deri 20 %	10
Më shumë se 20 %	0

Numri orientues i lëndëve

Neni 85

(1) Këshilli miraton metodologji me indikatorë për vërtetimin e ndërlikueshmërisë së lëndës sipas sferës juridike, ndërlikueshmërisë së materies dhe llojit të gjykatave, sipas shkallës dhe kompetencën reale në bazë të mendimeve të grumbulluara pozitive paraprakisht nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe e shpall në ueb faqen e vet.

(2) Këshilli çdo vit, me vendim e përcakton numrin orientues të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjykatësi në muaj në bazë të metodologjisë nga paragrafi 1 i këtij neni dhe mendimit nga mbledhja e gjykatësve, përkatësisht mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kriteri kuantitativ

Neni 86

(1) Kriter kuantitativ për punën e gjykatësit janë:

- vëllimi i punës së tij i cili vlerësohet nëpërmjet numrit dhe llojit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin orientues të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjykatësi në muaj të marra nga Sistemi i amortizuar kompjuterik për menaxhim me lëndët e gjyqit në gjykata,

- kuantiteti i punës së gjykatësit në pjesën e numrit të vendimeve të ndryshuara në raport me numrin e përgjithshëm të vendimeve normuese të zgjidhura.

(2) Nëse numri i lëndëve të zgjidhura për lloje të veçanta të lëndëve në raport me numrin e paraprak orientues arrin 100%, konsiderohet se gjykatësi i ka përmbushur kriteret kuantitative dhe vlerësohet me 40 pikë.

(3) Numri më i madh ose më i vogël i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e paraprak orientues të lëndëve vlerësohet në mënyrë që për çdo 1 % më shumë ose më pak të filluar, numri i pikëve nga paragrafi (3) i këtij neni rritet, përkatësisht zvogëlohet për 0,5 pikë, me ç'rast numri i përgjithshëm i pikave nuk mund të jetë më shumë se 60 pikë, as më pak se 20 pikë.

(4) Kuantiteti i punës së gjykatësit në pjesën e vendimeve ndërprera dhe të ndryshuara vlerësohet nëpërmjet kontrollit në sistemin e amortizuar kompjuterik për menaxhim me lëndët gjyqësore në gjykata me ç'rast merret parasysh vetëm numri i vendimeve kundër të cilave janë lejuar mjete juridike dhe të njëjtat janë ndërprerë ose ndryshuar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Vlerësimi nëpërmjet numrit të vendimeve të ndryshuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura

Neni 87

Puna e gjykatësit sipas numrit të vendimeve të ndryshuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura në periudhën në të cilën vlerësohet, vlerësohet në pajtim me këtë tabelë:

Përqindja e vendimeve të ndryshuara në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve të zgjidhura	Pikët
Deri 5 %	20
Prej 5 % deri 10 %	15
Prej 10 % deri 15 %	10
Prej 15 % deri 20 %	7
Prej 20 % deri 30 %	4
Më shumë se 30 %	0

Raste të posaçme të vlerësimit të punës së gjykatësit

Neni 88

(1) Nëse puna e gjykatësit është e tillë që vendimet e tij nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes së gjykatës më të lartë, përkatësisht kundër të njëjtave nuk janë paraqitur mjete juridike, gjykatësi do të marrë 105 pikë maksimale sipas kriterëve të këtij ligji dhe metodologjisë për vlerësim të gjykatësit.

(2) Nëse për gjykatës konkurron gjykatës i mëhershëm i gjykatës ndërkombëtare, kandidati për gjykatës merr vlerësim pozitiv.

Vlerësimi për punën e gjykatësit

Neni 89

(1) Vlerësimi i Këshillit për punën e gjykatësit mund të jetë pozitiv ose negativ.

(2) Në bazë të përmbledhjes së marrë të pikëve sipas kriterëve kualitativë dhe kuantitativë për vlerësimin e punës së gjykatësve, Këshilli i vlerëson gjykatësit me këto nota:

- 1) notë pozitive, nëse gjykatësi merr mbi 100 pikë,
- 2) notë negative nëse gjykatësi merr më pak se 100 pikë.

Vlerësimi i kryetarit të gjykatës që ka ndërmarrë obligim për gjykim të lëndëve

Neni 90

(1) Ndjekja dhe vlerësimi i punës së kryetarit të gjykatës i cili ka ndërmarrë obligim për gjykim të lëndëve bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji të cilat i përkasin kriterëve dhe procedurës për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së gjykatësit, me atë që në raport me vlerësimin e kriterit kuantitativ të këtij ligji, norma orientuese vlerësohet në 70 %.

(2) Pikët e marra nga vlerësimi i punës si gjykatës i kryetarit të gjykatës, i shtohen pikët e marra gjatë vlerësimit të tij si kryetar i gjykatës, nëse si kryetar i gjykatës është vlerësuar me notë pozitive, me atë që numri i përgjithshëm i pikëve nuk mund të tejkalojë 200 pikë.

Kritere kuantitative për vlerësimin e punës së kryetarit të gjykatës

Neni 91

Kriter kuantitative për vlerësimin e punës së kryetarit të gjykatës si kryetar i gjykatës janë të dhëna të cilat merren nga sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore në gjykata, nëpërmjet përqindjes së lëndëve të zgjedhura në lidhje me lëndët e pranuar në nivel të gjykatës.

Kritere kualitative për vlerësimin e punës së kryetarit të gjykatës

Neni 92

(1) Kriteret kualitative për vlerësim të punës së kryetarit të gjykatës, si kryetar i gjykatës janë:

- programi i realizuar për punën me planin aksionar,
- zbatimi i Rregullores gjyqësore e cila vlerësohet nëpërmjet kontrollit në raportet nga kontrollat e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata e lartë, Këshilli dhe Ministria e Drejtësisë,

- funksionimi i sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore i cili vlerësohet nëpërmjet kontrollit në raportet nga kontrollat e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata e lartë, Këshilli dhe Ministria e Drejtësisë,

- kualiteti i vendimit të marrë në administratën gjyqësore, e cila përcaktohet nëpërmjet kontrollit në pesë lëndë me zgjedhje të rastësishme nga sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhimin e lëndë gjyqësore dhe pesë lëndë të përcaktuara nga kryetari i gjykatës, në periudhën e vlerësimit, me çka vlerësohet baza ligjore, kuptueshmëria dhe qartësia e gjuhës në vendim, argumentimi i qartë i të gjitha fakteve, rrethanave dhe dëshmimeve dhe

- marrëdhëniet me publikun dhe transparenca në punë, të cilat vlerësohen nëpërmjet kontrollit në ueb faqen e gjykatës (njoftime për punën e gjykatës, vendime të publikuara, analiza dhe raporte për punën e gjykatës dhe të ngjashme) dhe qasje e lirë tek informatat me karakter publik.

(2) Të dhënat për përcaktimin e rezultateve nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohen nga raporti vjetor i punës së gjykatës i cili është shqyrtuar në seancën e përgjithshme nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, programi i punës së kryetarit të gjykatës, raportet nga kontrollat e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata e lartë, Këshilli dhe Ministria e Drejtësisë.

(3) Gjatë vlerësimit të punës së kryetarit të gjykatës merren parasysh edhe rrethanat të cilat kanë pasur ndikim në realizimin e programit për punë, kurse në të cilat kryetari nuk ka mundur të veprojë.

(4) Komisionin nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni e formon Këshilli dhe është i përbërë nga pesë anëtarë gjykatës së lartë të drejtëpërdrejtë.

(5) Formularët dhe metodologjinë për vlerësim të këtij neni i miraton Këshilli në bazë të mendimit nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vlerësimi me pikë i kritereve kuantitative

Neni 93

Përqindja e lëndëve të zgjedhura në nivel të gjykatës në lidhje me lëndët e pranuar vlerësohet me pikë sipas tabelës në vijim:

Përqindje e lëndëve të zgjedhura në raport me lëndët e pranuar	Pikët
Më shumë se 110%	40
Nga 105% deri më 110%	35

Nga 100% deri më 105%	30
Nga 90% deri më 100%	20
Nën 90%	0

Vlerësimi me pikë i kritereve kualitative

Neni 94

(1) Programi i realizuar për punë të kryetarit të gjykatës vlerësohet me pikë në pajtim me vlerësimin e komisionit për vlerësim për përqindje të aktiviteteve të realizuara sipas viteve, sipas tabelës në vijim:

Përqindje e programit të realizuar për punë	Pikët
81% - 100%	60
51% - 80%	30
Nën 50%	0

(2) Zbatimi i Rregullores Gjyqësore (Orari vjetor i punës, përjashtimi i gjykatësve, risistemim i lëndëve dhe ngjashëm) vlerësohet me pikë në pajtim me tabelën në vijim:

Zbatimi i Rregullores së Gjykatës	Pikët
Nuk ka jokonsekuencë të konstatuar në raportet nga kontrollet e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata më e lartë, Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë	40
Ka jokonsekuencë të konstatuar në raportet nga kontrollet e rregullta dhe të jashtëzakonshme nga gjykata më e lartë, Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë dhe ato janë tejkaluar në pajtim me rrekomandimet dhe afatet e raporteve	20

(3) Funksionimi i sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore vlerësohet me pikë në pajtim me tabelën në vijim:

Funksionimi i sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore	Pikët
Funksionimi ligjor konsekuent i sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore	20
Ka jokonsekuencë të konstatuar në funksionimin ligjor të sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore nga organi kompetent dhe ato janë tejkaluar sipas rekomandimeve të afateve në raporte.	10

(4) Kualiteti i vendimit të miratuar në administratë gjyqësore (vlerësohet baza ligjore, kuptueshmëria dhe qartësia e gjuhës në vendim, argumentimi i qartë i të gjitha fakteve, rrethanave, dëshmimeve) vlerësohet me pikë sipas tabelës në vijim:

Nota mesatare nga Komisioni për kualitet të vendimit të miratuar në administratën gjyqësore	Pikët
Nga 8-10	20

Nga 5-8	15
Nga 3-5	10
Nën 3	0

(5) Kriteri marrëdhënie me publikun dhe transparenca në punë vlerësohet me pikë sispas tabelës në vijim:

Nota mesatare nga Komisioni për kualitet të informatave të publikuara	Pikët
Nga 8-10	20
Nga 5-8	15
Nga 3-5	10
Nën 3	0

(6) Kryetari i gjykatës për kualitet të realizuar në punën si kryetari i gjykatës vlerësohet me maksimum 160 pikë.

Vlerësimi i kryetarit të gjykatës

Neni 95

Këshilli e vlerëson punën e kryetarit të gjykatës si kryetar i gjykatës me vlerësimet si vijojnë:

- vlerësim pozitiv, mbi 100 pikë
- vlerësim negativ, nën 100 pikë.

Vendimi për vlerësim

Neni 96

(1) Këshilli miraton vendim të arsyetuar për vlerësimin e punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej tetë ditësh nga dita e miratimit të tij i dorëzohet gjykatësit, përkatësisht kryetarit të gjykatës për të cilin është mbajtur procedurë për vlerësim.

(3) Gjykatësi përkatësisht kryetari i gjykatës ka të drejtë për kundërshtim të arsyetuar të vlerësimit që e kanë marrë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të Vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Këshilli në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i kundërshtimit debaton për kundërshtimin dhe miraton vendim për refuzimin ose pranimin e kundërshtimit ose vendimit për rivlerësim.

(5) Kundër vendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, gjykatësi përkatësisht kryetari i gjykatës kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së vendimit, te Këshilli për Ankesa në mënyrë dhe procedure të përcaktuar me këtë ligj.

Rivlerësimi

Neni 97

(1) Këshilli detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit nga neni 96 paragrafi (4) respektivisht paragrafi (5), të kryejë rivlerësim të punës së gjykatësit dhe të kryetarit të gjykatës.

(2) Rivlerësimi i punës së gjykatësit dhe kryetarit të gjykatës kryhet në bazë të raportit të Komisionit të përbërë prej tre anëtarëve të Këshillit, në të cilin nuk mund të anëtarësohen persona të cilët kanë qenë anëtarë të Komisionit i cili e ka propozuar vlerësimin e gjykatësit gjatë vlerësimit të parë.

(3) Kundër vendimit për rivlerësim të miratuar nga Këshilli, gjykatësi dhe kryetari i gjykatës nuk kanë të drejtë ankese, as kundërshtimi.

Propozim për zgjedhje të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 98

(1) Këshilli nga radha e gjykatësve me së paku 15 vjet stazh gjyqësor, me vlerësim paraprak të përcaktuar të rezultateve të tyre të përgjithshme në punën dhe kontributin për zhvillimin e mendimit teorik dhe profesional dhe të sistemit juridik, i propozon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dy kandidatë për zgjedhje të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Propozimin nga paragrafi (1) i këtij neni Këshilli e përcakton me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Rregulloren e punës të Këshillit.

Vendimi për marrjen e imunitetit të gjykatësit dhe vendosja për kërkesën për paraburgim

Neni 99

(1) Këshilli vendos për marrjen e imunitetit të gjykatësit në raste të përcaktuara me ligj, në mbledhje të Këshillit me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm i antarëve të këshillit me të drejtë vote.

(2) Këshilli në mbledhje vendos me së paku shtatë vota nga numri i përgjithshëm i antarëve të këshillit me të drejtë vote, për kërkesën për miratimin e paraburgimit të gjykatësit, përkatësisht për njoftimin se gjykatësi është paraburgosur.

(3) Procedura në të cilën Këshilli vendos për heqjen e imunitetit të gjykatësit është urgjente dhe zbatohet në afat prej 24 orësh nga kërkesa e dorëzuar, përkatësisht njoftimi për paraburgim.

Raporti i punës

Neni 100

(1) Këshilli për punën e vet i parashtron Raport Vjetor Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 30 prill të vitit rrjedhës për vitin paraprak.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni shpallet publikisht në ueb faqen e Këshillit.

(3) Në raport janë përfshirë të dhënat:

- për numrin e kryetarëve të zgjedhur dhe të shkarkuar të gjykatave, gjykatësve dhe gjykatësve porotë,
- për numrin e procedurave të ngritura dhe të përfunduara për përcaktimin e përgjegjësisë,
- për gjendjen kadrovike në gjyqësi,
- për gjendjen materiale-financiare në gjyqësi,
- për gjendjen e gjykatave në apjtim me raportet vjetore për punën e tyre.
- të dhëna për veprimin sipas procedurave dhe propozimeve nga qytetarët dhe institucionet për punën e gjykatësve dhe gjykatave.

(4) Raporti përmban edhe vlerësimin për punën e gjykatësve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me kualitetin dhe azhurnimin e punës së tyre, si dhe çështje tjera në lidhje me relaizimin e pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësisë.

(5) Raporti përmban edhe të dhëna për shkallën e realizimit të Programit vjetor për punën e Këshillit sipas zërave.

(6) Këshilli në mbledhje e miraton raportin për punën e vet, me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote dhe i'a dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim dhe miratim.

(7) Pas miratimit të raportit për punën e vet, Këshilli ua dorëzon të gjitha gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(8) Nëse Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e miraton raportin, kjo do të jetë baza për fillimin e debatit të organet që i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit Gjyqësor për vlerësim të punës së tyre në këshill.

VI. SHËRBIMI PROFESIONAL I KËSHILLIT

Shërbimi profesional

Neni 101

(1) Këshilli ka shërbim profesional i cili kryen punë administrative, teknike - profesionale, organizative, informatike, hulumtuese dhe financiare për nevojat e Këshillit.

(2) Me Shërbimin profesional udhëheq sekretari i përgjithshëm.

(3) Këshilli miraton akte për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

(4) Gjatë punësimit në Shërbimin profesional të Këshillit sigurohet përfaqësim përkatës dhe i drejtë i qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(5) Skeretari i përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Këshillit pa të drejtë vote dhe mund të propozojë pika të rendit të ditës.

Statusi i të punësuarve në Shërbimin profesional të Këshillit

Neni 102

(1) Sekretari i përgjithshëm dhe të punësuarit në Shërbimin profesional e kanë statusin e nëpunësve profesionalë.

(2) Sekretarin e përgjithshëm e zgjedh Këshilli me së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

(3) Kandidatët për Sekretari të përgjithshëm, krahas kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës në gjykatë, përkatësisht kushteve të përcaktuara me Ligjin për nëpunës administrativë, duhet të kenë edhe tetë vite stazh pune pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

(4) Për çështjet që kanë të bëjnë për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë, rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune dhe ky ligj.

Qendra për TIK

Neni 103

(1) Në Këshill formohet Qendra për teknologji-informative komunikative, analitike dhe statistikë (në tekstin e mëtejme: Qendra për TIK) që është përgjegjëse për ruajtjen e bazës së të dhënave për dosje elektronike të gjykatësve, lista të kandidatëve për zgjedhje të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, vlerësimin e gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave dhe bazës së të dhënave për punë financiare dhe materiale të shfrytëzuesve individë të buxhetit gjyqësor.

(2) Qendra për TIK është përgjegjëse për ruajtjen e bazës replikuese të të dhënave për Sistem informatik gjyqësor që është e vendosur në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shfrytëzohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Qendra për TIK i koordinon aktivitetet e qendrave tjera për informatikë në gjyqësi me qëllim të përmirësimit të zgjidhjeve harduerike dhe softuerike në gjyqësi.

VII. MJETET E PUNËS

Neni 104

Mjetet e punës së Këshillit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pjesa e shënuar si Pushteti gjyqësor.

Neni 105

Roga e anëtarëve të Këshillit, sekretarit të përgjithshëm dhe nëpunësve gjyqësorë përcaktohet me ligj.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 106

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj Këshilli detyrohet t'i miratojë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 107

(1) Procedurat e filluara për zgjedhje të gjykatësist në gjykatën më të lartë ose kryetarit të gjykatës ose anëtarit të Këshillit gjyqësor deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për Këshill Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 60/2006, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15, 197/17 dhe 83 /18).

(2) Procedurat e filluara për shkarkimin e gjykatësit ose kryetarit të gjykatës deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për Këshill Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 60/2006, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15, 197/17 dhe 83 /18).

(3) Procedurat e filluara për përcaktimin e masë disiplinore të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për Këshill Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 60/2006, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15, 197/17 dhe 83 /18).

(4) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndë gjyqësore në gjykata do të harmonizohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji në afat prej 18 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Deri në harmonizimin e Sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore në gjykata në pajtim me dispozitat e këtij ligji do të zbatohet sistemi i automatizuar kompjuterik ekzistues për udhëheqje me lëndët gjyqësore në gjykata.

Neni 108

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 60/2006, 150/10, 100/11, 20/15, 61/15, 197/17 dhe 83 /18).

Neni 109

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.